Funded by the European Union

Zgjidhje inovative digjitale komunale në Komunën e Tetovës



Duration: 17.01.2022 - 16.05.2026

Countries:
North Macedonia

EU contribution: € 523 647

Total budget: € 616 055

Implementer:
Municipality of Tetovo, Albiz Foundation

Social media:
facebook.com/profile.php?id=61572456922921

Website(s): teklik.mk/

Project description:

Projekti “Zgjidhjet inovative digjitale komunale në Komunën e Tetovës” mbështet transformimin digjital të qeverisjes lokale përmes modernizimit të shërbimeve komunale dhe përmirësimit të disponueshmërisë, efikasitetit dhe transparencës së tyre. Ai u përgjigjet nevojave urbane në rritje, si dhe sfidave administrative, duke futur mjete të integruara digjitale, të cilat thjeshtojnë funksionet kryesore komunale.

Iniciativa përqendrohet në zhvillimin e një platforme TIK(teknologjike informacioni dhe komunikimi), e cila digjitalizon shërbimet që lidhen me planifikimin urban, taksat dhe inspektimin. Duke u lidhur me sistemet kombëtare, siç është kadastra, platforma u lejon qytetarëve dhe bizneseve të kenë qasje në shërbime online, të paraqesin kërkesa dhe të monitorojnë procedurat në kohë reale. Kjo zvogëlon barrën administrative, shkurton kohën e përpunimit dhe përmirëson ofrimin e shërbimeve.

Duke përforcuar kapacitetet institucionale dhe duke prezantuar zgjidhje inovative digjitale, projekti kontribuon në një qeverisje lokale më të përgjegjshme dhe mbështet Komunën e Tetovës në tranzicionin drejt një komune më të zgjuar dhe më të qëndrueshme.

Expected results:

• Shërbime komunale të digjitalizuara plotësisht dhe të integruar në një ekosistem funksional online, të cilat mundësojnë ofrimin e shërbimeve më të shpejtë dhe më transparente;
• Planifikim urban i përmirësuar përmes digjitalizimit dhe integrimit të të gjitha planeve urbane në një platformë të vetme GIS;
• Kopetenca digjitale të përmirësuara të stafit komunal dhe aftësi të menaxhimit të të dhënave të përmirësuara dhe për të ofruar shërbime elektronike;
• Krijim i kapaciteteve të qëndrueshme për inovacion të vazhdueshëm digjital, duke mbështetur përmirësimet afatgjata në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve.